

Në kuadër të nënshkrimit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me universitete të vendit dhe të huaja për të zgjeruar bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët, ditën e diel dt. 01.10.2017 në ambientet e UGJ u zhvillua nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit tonë dhe Universitetit të Gjuhëve të Huaja të Pekinit.

Ky bashkëpunim është tërësisht në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UGJ, ku një pikë e rëndësishme e së cilës synon të zgjerojë dhe të forcojë rjetin e Universiteve ku studiohet gjuha shqipe. BFSU është një prej universiteteve të rendit parësor në Pekin. Në këtë universitet gjendet katedra e vetme e albanologjisë në Azi. Ka 25 studentë në Bachelor, 10 në Master dhe 5 në PhD.

Gjithashtu, nisur nga interesi i përbashkët për bashkëpunim në fushën e mësimdhënies universitare dhe të kërkimit shkencor kjo marrëveshje kuadër mundëson shtrirjen e bashkëpunimit tonë edhe në Departamentet e tjera të UGJ me profil të gjuhëve të huaja, si Departamenti i Gjuhës Angleze, Italiane e Greke.



